

NOTË INFORMUESE

Mbi kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedim disiplinor me masën

« Ulje e përkohshme e pagës në masën 40% për një afat një vjeçar » për magjistratin D.G.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka nisur më 29.07.2024 hetimin disiplinor me nismë të ankuesit ndaj magjistratit D.G., prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, dhe më 29.01.2025 ka shtuar objektin e hetimit ndaj këtij magjistrati, duke realizuar hetim për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “ç” dhe “dh” i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Hetimi disiplinor i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka konstatuar :

- Mospërmbushje të pajustificuar dhe të përsëritur të funksioneve gjatë hetimit;
- Veprime dhe sjellje të magjistratit që ka sjellë dëme për palët në një procedurë hetimore në kundërshtim me ligjin. Këto veprime/mosveprime të magjistratit janë parashikuar si shkelje disiplinore nga neni 102 pika 1 shkronjat “ç” dhe “dh”, të ligjit nr. 996/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- Formën dhe shkallën e fajësisë nëpërmjet kryerjes së shkeljes disiplinore me pakujdesi në formë neglizhence;
- Vjetërsinë e magjistratit në sistemin e drejtësisë dhe të dhënat mbi aftësitë profesionale të tij, që dëshmon njohjen e mirë të ligjit dhe procedurës.

Raporti hetimor konstaton se rrethanat e shkeljes nuk përbëjnë shkelje disiplinore shumë të rëndë dhe nuk është e përshtatshme një masë disiplinore më e rëndë; për pasojë i propozohet KLP-së caktimi ndaj prokurorit D.G., të masës disiplinore “*Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 për qind, për një periudhë jo më të gjatë se një vit*” parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja “c”, ndarja “i” dhe neni 108 i ligjit nr. 96.2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.